



Datë: 02.09.2025
Numër Protokolli: 5897/2025

A.nr.1095/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1095/2025, të datës 09.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.S kundër organit të punësimit/ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.09.2025 mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1095/2025, e datës 09.06.2025 e parashtruar nga ankuesi, A.S.

A r s y e t i m

Ankuesi, A.S. (në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesi), me datë 09.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3840/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1095/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017064, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 25.03.2025, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, pozita Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm, klasa e pozitës, Drejtues i Mesëm, me pretendimet ankimore se hartimi i testimit me shkrim ka qenë jo në përputhje me dispozitat ligjore, ka pasur pyetje që me qëllim kanë vërë kandidatët në lajthitje, mos pjesëmarrja e komisionit të kompletuar gjatë mbajtjes së testimit me shkrim, që sipas ankuesit të gjitha këto përbejnë shkas për përsëritjen e kësaj procedure.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit, më datë 25.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me nr prot 3840/2025 të datës 09.06.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit e datës 25.03.2025 me numër reference RN00017064; Njoftimi i datës 05.05.2025 për verifikimin paraprak nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; E-mal i datës 03.06.2025; E-mal I datës 15.05.2025; Kopja e testit me shkrim për ankuesin; Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve e datës 19.05.2025; Njoftimi I datës 19.05.2025 për anulimin e konkursit; ID kartela e ankuesit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës 25.07.2025; Formulari I vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimi i datës 19.05.2025; Vendimi me nr.180/2025 të datës 14.05.2025 për themelimin e komisionit të vlerësimit; Akt emërimi me Nr.120/2024 i datës 01.04.2024 për Sh.H; Aplikacioni i datës 23.04.2025 i kandidatit A.S bashkë me dokumentet e kërkuara.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me datë 25.03.2025 ka bërë njoftimin për pozitën Drejtues i mesëm titulli i vendit të punës Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm me afat aplikimi nga data 26.03.2025 deri më datë 24.04.2025 me numër RN00017064. Konkursi është shpallur në harmoni me Rregulloren 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës me kritere si vijon:

- a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Arsim i lartë i paspecifikuar, në fushën Ekonomike (pavarësisht nga specializimi), Juridik, Administratë Publike dhe Financa Publike;
- b) Kërkesat specifike: Certifikata për auditim të brendshëm në sektorin publik;
- c) Përvoja e punës e kërkuar:
 - c.1.) tri (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose
 - c.2.) dy (2) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose
 - c.3.) një (1) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë katër (4) kandidatë, ku prej tyre dy (2) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin, cili ka marrë pjesë në testimin me shkrim duke arritur gjithsejtë 49,8 pikë nga kjo procedurë rekrutimi, të pa mjaftueshme për të hyrë në fazën tjetër të rerrutimit.

Lidhur me trajtimin e pretendimeve të ankuesit Kolegji ju referua analizimit të testimit me shkrim të ankuesit konstatoi se i njëjti nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 49,8 pikë (prej të cilave 34 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 15,8 pikë nga eseja), dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me vlerësimin e eses apo testimit me shkrim, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullore (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën E Pranimi Në Shërbimin Civil ku përcaktohet: “Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publike që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet

vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit” si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: “6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimin, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimin.” dhe konstatoi se sistemi që funksionon në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlen njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, sikurse edhe në rrethanat e rastit konkret, ndërsa Komisioni i Pranimin e vlerëson vetëm esenë, nga rrjedh se sipas testit me shkrim me shifër CN7523-ankuesi, për vlerësimin e eses nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me gjithsej (15.6) pikë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 9 të së njëjtës rregullore: “9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimin në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim.” dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet e ankuesit nuk janë të bazuara, ashtu që Kolegji i Këshillit nuk gjeti se në këtë fazë ka pasur shkelje sikurse ankuesi pretendon për shkelje esenciale të drejtave të barabarta të kandidatëve, për rrjedhojë ankuesi nuk ka arritur ta argumentojë faktin me asnjë provë se për çfarë arsye i njëjti është dashur të vlerësohet me më shumë pikë në testin me shkrime shkrim, përderisa nuk ka arritur të argumentoi faktin se cilat pyetje kanë qenë të përpiluara në mënyrë jo të saktë, gjegjësisht i njëjti e ngrit në formë të supozimit këtë pretendim, mirëpo të njëjtin nuk e mbështet me prova relevante apo fakte të provueshme.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi procedura e rekrutimit ka përfunduar pa kandidatë fitues dhe konstatimit si më lartë se pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar, Kolegji i Këshillit vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu që refuzoi ankesën e ankuesit të datës 09.06.2025.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA:A.nr.1095/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.S;
- Njesisë se Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.